



KOSOVO LOCAL
GOVERNMENT
INSTITUTE

ANALIZË

QEVERISJA LOKALE NË TRI DIMENSIONE

(NDËR-INSTITUCIONAL, NDËR-KOMUNAL
DHE BRENDA-KOMUNAL)



Norwegian Embassy

DEM
Dialogue for European Municipalities

Aktiviteti u realizua në kuadrin e programit 'Dialogu për Komunitat Evropiane' (DEM), i mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë.

Tabela e përmbajtjes

Përshkrim i përgjithshëm	3
Rrafshi Ndër-Institucional	4
Dialogu dhe komunikimi ndër-institucional	4
Problemet ndër-qeveritare	4
Financat lokale	6
Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Bashkëpunimi Ndër-Komunal	10
Përkrahja e qendrës për zhvillimet komunale	10
Qëndrueshmëria	10
Bashkëpunimi Ndër-Komunal	11
Rrafshi Komunal	15
Qeverisja Brenda-Komunale	15
Shërbimet Administrative dhe Publike	16
Demokracia e drejtpërdrejtë – qeverisja e mirë	17
Perspektiva e KLGJ mbi prioritetet e qeverisjes lokale	21
Koordinimi dhe dialogu i përhershëm me komunat	21
Politika dhe buxhete të integruara në funksion të zhvillimit	21
Zhvillimi Policentrik	21
Zonat e Veçanta Zhvillimore	21
Shërbime të Integruara dhe digjitalizimi	21
Qendrat për Projekte Zhvillimore	22
Adresimi i sfidave kyçe (të përbashkëta) për komunat e Kosovës	22
Qendra e Resurseve	22
Koordinimi i Fondeve Zhvillimore	22
Forcimin e bashkëpunimit rajonal	22

Përshkrim i përgjithshëm

Analiza përdor një qasje holistike, duke analizuar qeverisjen lokale në tri (3) rrafshë: ndër-institucional, ndër-komunal si dhe brenda-komunal. Dokumenti përfshin të gjetura nga raportet kredibile vendore dhe ndërkombëtare, si dhe informacione dhe të dhëna nga puna e Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ). Analiza është në harmoni me Strategjinë për Qeverisje Lokale 2016-2026, Strategjinë e KLGJ-së, zhvillimet rajonale dhe trendët ndërkombëtarë në fushën e qeverisjes lokale. Nëpërmjet kësaj analize, ofrohen pikëpamjet e KLGJ-së për statusin aktual të funksionimit të qeverisjes lokale, si dhe fushat për intervenim nga akterët.

Dokumenti është i ndarë në katër (4) kapituj të veçantë:

- i. **Kapitulli i parë (1)**, pasqyron dialogun dhe komunikimin ndër-institucional; problemet ndër-qeveritare dhe financat lokale;
- ii. **Kapitulli i dytë (2)**, trajton përkrahjen e qendrës për zhvillimet komunale; qëndrueshmërinë dhe bashkëpunimin ndër-komunal;
- iii. **Kapitulli i tretë (3)**, analizon qeverisjen brenda-komunale; shërbimet publike dhe administrative si dhe demokracinë e drejtpërdrejtë dhe qeverisjen e mirë; dhe
- iv. **Kapitulli i katër (4)**, paraqet perspektivën e Institutit KLGJ lidhur me: koordinimin dhe dialogun e përhershëm me komunat; politikat dhe buxhetet e integruara në funksion të zhvillimit; zhvillimin policentrik; zonat zhvillimore; shërbimet e integruara dhe digjitalizimin; qendrat për projekte zhvillimore; adresimin e sfidave kyçe (të përbashkëta) për komunat; qendrën e resurseve; koordinimin e fondeve zhvillimore dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal.

Dokumenti ofron një përshkrim/analizë të shkurtër referuar të dhënave nga raportet, strategjitë dhe politikat në fushën e qeverisjes lokale, ku në formën e kornizës logjike, paraqiten segmentet, fushat për intervenim dhe çështjet kyçe për adresim. Në kapitullin e parë (1), gjashtë (6) segmente, dhjetë (10) fusha – njëzetekatër (24) çështje; në kapitullin e dytë (2), shtatë (7) segmente, shtatë (7) fusha – nëntë (9) çështje dhe në kapitullin e tretë (3), njëmbëdhjetë (11) segmente, njëmbëdhjetë (11) fusha – pesëmbëdhjetë (15) çështje.

Dokumenti u shërben akterëve institucionalë dhe publikë, si pikë nisje dhe referuese për problematikat kyçe në fushën e qeverisjes lokale, si një instrument orientues për intervenimet kryesore në segmente dhe fusha të rëndësishme. Njëkohësisht, mund të shërbehet me informacione mbi perspektivën e Institutit KLGJ, të bazuar në modelet dhe trendët e qeverisjes lokale.

Rrafshi ndër-Institucional

Dialogu dhe komunikimi ndër-institucional

Komunat si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale¹ dhe niveli qendror nuk kanë ndërtuar mekanizma të qëndrueshëm të komunikimit dhe konsultimit. Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026, në kontekstin e problemeve, tek pjesa organizative, thekson se *“procesi i komunikimit, i bashkërendimit dhe i bashkëpunimit të brendshëm dhe atij të jashtëm, e sidomos, koordinimi ndër-institucional është përcjellë me mangësi të theksuara gjatë periudhës së kaluar”*². Shumë prej politikave, legjislacionit dhe udhëzimeve të hartuara dhe miratuara nga niveli qendror, hasin në pengesa në zbatim nga niveli lokal. Po kjo strategji, sa i përket problemeve ligjore thekson se *“për shkak të ndryshimeve të shpeshta në kuadër të rendit juridik, pas vitit 1999 sa i përket aplikimit të ligjeve të miratuara në periudha të ndryshme, si dhe mungesa e harmonizimit të plotë vertikal dhe horizontal të kornizës ligjore, si dhe plotësimi me legjislacionin sekondar, kanë qenë disa nga vështirësitë dhe sfidat”*³.

Në mungesë të mekanizmave të dialogut dhe komunikimit ndër-institucional, mund të rritet hendeku dhe zbatimi i pjesshëm dhe i paqartë i politikave/legjislacionit. Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, kërkon që *“koha e konsultimit duhet të jetë e tillë që t’u lejojë organeve vendore të kenë mundësi reale të ushtrjnë ndikimin e tyre, ndërkohë që pranojnë që rrethanat përjashtimore mund të çojnë në anashkalimin e kërkesës për konsultim, në veçanti në raste urgjencash. Ky konsultim, duhet të zhvillohet drejtpërsëdrejti me organin ose organet e prekura vendore, ose në mënyrë të tërthortë me anë të shoqatave të tyre në rastet kur bëhet fjalë për përfshirjen e disa pushteteve vendore”*⁴. Mungesa e përfshirjes dhe pronësisë së komunave në hartimin e politikave, rritë paqartësitë dhe kufizon efektshmërinë e tyre. Pavarësisht përpjekjeve të mekanizmave të caktuar institucionalë, një qasje e integruar dhe sistematike ende nuk është konsoliduar. Komunat shpesh ballafaqohen me paqartësi ligjore, kompetencash institucionale dhe adresash të llogaridhënies. Kjo, frenon zhvillimin e politikave dhe ndërmarrjen e veprimeve efikase ndër-institucionale. Për këtë, Strategjia për VQL (2016-2026), kërkon *“zhvillimin e sistemit të integruar të vetëqeverisjes lokale, si një qasje gjithëpërfshirëse për realizimin e objektivave”*⁵.

Problemet ndër-qeveritare

Si në çdo sistem qeverisës, mosmarrëveshjet ndër-institucionale janë të pa shmangshme. Në veçanti në sistemin një shkallësh, ku shpesh legjislacioni bazik dhe ai sekondar kanë dykuptimësi dhe mbivendosje. Ky problem evidentohet edhe në Strategjinë për VQL (2016-2026), ku ndër të tjera theksohet se *“përcaktimi jo mjaft i qartë dhe uniform i kompetencave ka prodhuar paqartësi menaxhuese dhe tendencë për rikthim të kompetencave, në nivelin qendror”*⁶. Ndërkaq, Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, thekson se *“për të qenë të qartë dhe për qëllimin e shmangies së çdo tendence për pakësim të vazhdueshëm të përgjegjësisë, kompetencat normalisht duhet të jenë të plota dhe ekskluzive. Mirëpo, pavarësisht nga kjo, në fusha të caktuara, kërkohen veprime plotësuese nga nivelet e ndryshme të qeverisjes dhe në këto raste është e rëndësishme që ndërhyrja nga organet qendrore dhe rajonale të*

¹ Neni 124 [Organizimi dhe Funkcionimi i Vetëqeverisjes Lokale], pika 1, Kushtetuta e Kosovës

² Strategjia për Vetëqeverisje Lokale (2016-2026)

³ Po aty

⁴ Karta-Evropiane-e-Autonomise-Vendore.pdf (shtetiweb.org)

⁵ Po aty

⁶ Strategjia për Vetëqeverisje Lokale (2016-2026)

kryhen në përputhje me dispozita të qarta legislative”⁷. Në shumë raste, këto paraqesin probleme në zbatimin efikas të kompetencave dhe llogaridhënies.

Pavarësisht se në Kosovë qeverisja lokale rregullohet përmes legjislacionit bazik, shumë nga ministritë sektoriale nxjerrin obligime për komunat. Në Strategjinë për VQL (2016-2026), theksohet se “në vitet në vijim agjenda legislative fokusin kryesor do ta ketë në vlerësimin dhe harmonizimin e legjislacionit ekzistues”⁸. Në shumicën e herëve, komunat ballafaqohen me obligime që dalin nga ky legjislacion, e që në procesin e zbatimit dhe raportimit, kufizohen nga kapacitetet e limituara financiare, profesionale, teknike dhe operacionale. Këtë e vendos në pah edhe Raporti i Progresit për Kosovën (2019), ku ndër të tjera thekson se “megjithëse, pushteteve lokale u janë dhënë më shumë kompetenca, burimet e tyre njerëzore dhe financiare shpesh janë të pamjaftueshme. Kapacitetet e kufizuara dhe vështirësitë në zbatimin e ligjeve, rregulloreve, politikave dhe procedurave e dëmtojnë cilësinë e ofrimit të shërbimeve komunale”⁹. Në mungesë të një mekanizmi të veçantë për zgjidhjen e shpejtë të mosmarrëveshjeve, adresimi i problemeve kufizon komunat në vendimmarrje efikase. Strategjia për VQL (2016-2026), ka vendosur objekt trajtimi “evidentimin e kompetencave qendrore dhe lokale, përcaktimin e marrëdhënies së qartë për mbikëqyrjen e ligjshmërisë ndërmjet nivelit qendror dhe lokal, si dhe harmonizimin e kundërtshënive ndërmjet ligjeve, por edhe akteve nënligjore”¹⁰. Për më tepër, ndërrimet e shpeshta të qeverive, shpërfaqin problemet në nismat e përbashkëta të dyja niveleve.

Mungesa e një vlerësimi sistematik dhe sektorial për problemet komunale, në vazhdimësi ballafaqon komunat me paqartësi. Në analizën “Komunat dhe Ligjet” nga hulumtimi i Institutit GAP, në 32 komuna të Kosovës del se “komunat përballen me vështirësi të shumta në zbatimin e ligjeve për të cilat janë përgjegjëse”¹¹. Përderisa, në raportin e përmbushjes së obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane (2020), theksohet se “Disa nga sfidat e paraqitura në njëzetepesë (25) komuna, në zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore janë: bashkëpunimi i dobët në mes të nivelit qendror dhe nivelit lokal në hartimin e këtyre politikave, mungesa e konsultimeve paraprake i cili është obligim ligjor, mungesa e stafit profesional, mungesa e pjesëmarrjes në trajnime me qëllim të aftësimin profesional, mungesa e informimit të qytetarëve, barrierat gjuhësore etj. Në anën tjetër, janë trembëdhjetë (13) komuna të cilat nuk hasin në ndonjë vështirësi”¹².

Ndërkohë që, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, specifikon fushat ku kërkohen marrëdhëniet ndër-institucionale, përveç gjykatave, nuk parashihet një mekanizëm specifik për adresimin e paqartësive dhe mosmarrëveshjeve. Kjo, vjen edhe si nevojë e numrit të lartë të ushtrimit të përbashkët të kompetencave. Në analizën e GAP-it, gjithashtu, theksohet se “nga nëntëmbëdhjetë (19) kompetencat vetanake që i parashihet Ligji për Vetëqeverisje Lokale, asnjëra nuk ushtrohet ekskluzivisht vetëm nga Komuna. Pjesa më e madhe e këtyre kompetencave mund të ushtrohen pas procedurave ose pajtimeve që duhet të marrin komunat nga niveli qendror. Madje, një pjesë tjetër e këtyre kompetencave mund të ushtrohen direkt nga niveli qendror”¹³.

⁷ Karta-Evropiane-e-Autonomise-Vendore.pdf (shtetiweb.org)

⁸ Po aty

⁹ Raporti i Progresit për Kosovën (2019)

¹⁰ Strategjia për Vetëqeverisje Lokale (2016-2026)

¹¹ 2403_Komunat dhe Ligjet - final.pdf (institutigap.org)

¹² <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/03/Raporti-per-permbushjen-e-obligimeve-te-komunave-nga-Agjenda-Evropiane-p....pdf>

¹³ 94817_Gap Analizë 5 kompetencat.pdf (institutigap.org)

Financat lokale

Ligji për Financat e Pushtetit Lokal ka qenë derivat i Pakos së Ahtisaarit¹⁴, si nevojë e financimit të komunave me ndryshimet strukturore dhe të kompetencave në këtë nivel. Paraprakisht, kjo fushë është ushtruar përmes rregulloreve të UNMIK 1999/16¹⁵ dhe 2000/7¹⁶ (për themelimin e autoritetit qendror fiskal të Kosovës dhe çështje të tjera lidhur me të). Problemet që dalin në procesin e financave të pushtetit lokal, përvitshëm përsëriten edhe në Raportet e Progresit për Kosovën, ku ai i vitit 2020 thekson se *“reformat legislative janë të nevojshme për të ristrukturuar financimin dhe kompetencat midis qeverisë qendrore dhe lokale dhe për të krijuar një grant specifik për shërbimet sociale”*¹⁷.

Po në këtë raport, vendoset në pah edhe financimi nga ministritë e linjës, duke nënvizuar se *“përveç transfereve të rregullta në formën e një granti të përgjithshëm, komunat marrin fonde të konsiderueshme për investime kapitale sipas gjykimit të ministrive të linjës”*. Në këtë kontekst, krijimi i një granti të performancës komunale nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, i cili vendos rregulla jo të politizuara për disbursimin e grantit, është një hap i mirëpritur. Ministritë e tjera, gjithashtu, duhet të zhvillojnë mënyra për të disbursuar grantet e tyre në një mënyrë të drejtë, transparente dhe të bazuar në rregulla.¹⁸ Për këtë, përpilimi i LFPL-së së ri konsiderohet si çështje prioritare, pasi që është pjesë e ndryshimeve në dy strategji (Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 dhe Strategjia për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike 2016-2020), dhe përtej aspekteve financiare, ka impakt direkt në mënyrën e funksionimit, kapaciteteve dhe kompetencave komunale, duke mos përjashtuar edhe rolin e ministrive sektoriale.

LFPL-ja ka ndërlidhje të theksuar me prioritetet e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026, përkatësisht me pikën e parë të objektivës së tretë, e cila përfshin rritjen e aftësisë financiare dhe kapaciteteve profesionale për planifikimin dhe menaxhimin e financave lokale dhe Raporteve Vjetore për Përshtatshmërinë e Financimit Komunal të hartuara nga Ministria e Financave. Duke pasur parasysh rëndësinë dhe ndjeshmërinë e kësaj fushe, ndryshimi i LFPL-së duhet të kalojë në një proces të gjerë të analizës, krahasimit dhe konsultimit me të gjithë akterët.

¹⁴ https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/1DC6B184D02567D1852572AA00716AF7-Full_Report.pdf

¹⁵ https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A1999regs/RA1999_16.htm

¹⁶ https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2000regs/RA2000_07.htm

¹⁷ Raporti i Progresit për Kosovën (2020)

¹⁸ Po aty

	Segmenti	Fushat për Intervenim	Çështjet kyçe për adresim
Dialogu dhe komunikimi ndër-institucional	<p>Qartësimi i legjislacionit, politikave dhe llogaridhënies ;</p> <p>Mekanizma ndër-institucionale për komunikim dhe konsultim efektiv; dhe</p> <p>Përfshirja e partnerëve në agjendën lokale.</p>	<p><u>Konsolidimi i mekanizmave të konsultimit dhe komunikimit:</u> Qeveria, komunat dhe akterët tjerë duhet të propozojnë/hartojnë një qasje për forcimin e dialogut dhe komunikimit ndër-qeveritar dhe agjendë veprimi.</p> <p><u>Ndërtimi i sistemit të integruar ndër-qeveritar:</u> Qeveria dhe komunat, në kuadrin e vendimmarrjes, duhet të hartojnë një sistem të integruar, duke përfshirë edhe kalendarin e veprimeve kyçe ndër-institucionale;</p> <p><u>Konsultimi me partnerët zhvillimorë:</u> Në agjendën e veprimit, konsultimi dhe koordinimi me partnerët zhvillimorë, do të forconte kohezionin dhe fokusin e mbështetjes.</p>	<p>Përfshirja e Komunave në diskutimet rreth politikave dhe në hartimin e ligjeve, si dhe në komunikimin e përgjithshëm ndërqeveritar;</p> <p>Hartimi i një plani të veprimit për pjesëmarrjen e komunave në politik-bërjen e nivelit qendror;</p> <p>Fuqizimi i rolit të autoriteteve të përfaqësimit të komunave, në adresimin e çështjeve vitale për komunat;</p> <p>Ndërtimi i sistemit të integruar në hartimin, zbatimin e politikave për nivelin lokal, për të shmangur copëzimin e politikave dhe buxheteve;</p> <p>Hartimi i agjendës së përbashkët dhe kalendarit të vendimmarrjes ndër-institucionale;</p> <p>Hartimi i agjendës për qeverisjen lokale të përfshijë edhe partnerët zhvillimorë dhe shoqërinë civile;</p> <p>Harmonizimi i veprimeve mes mekanizmave institucionale, partnerëve zhvillimorë dhe shoqërisë civile.</p>

<p>Problemet ndër-qeveritare</p>	<p>Ndërtimi i mekanizmit për qartësim të kompetencave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;</p> <p>Procesi i hartimit politikave/legjislacionit sekondar t'i definojë qartë obligimet për komunat;</p> <p>Politikat e reja të jenë në harmoni me kompetencat dhe strukturën komunale.</p>	<p><u>Ndërtimi i mekanizmit për qartësim të kompetencave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve:</u> Në procesin e rishikimit, duhet analizuar nevoja për mekanizma që ndihmojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndër-institucionale. Ndërkaq, aktualisht ministria përgjegjëse për Pushtet Lokal, duhet të rrisë komunikimin për qartësim të përgjegjësive në mes komunave dhe ministrive sektoriale;</p> <p><u>Procesi i hartimit politikave/legjislacionit sekondar t'i definojë qartë obligimet për komunat:</u> Konsultimi paraprak, duhet të forcohet, në veçanti, nga ministrinë sektoriale me komunat dhe ministrinë përgjegjëse, në veçanti në analizimin dhe harmonizimin e legjislacionit për ta shmangur ambiguitetin;</p> <p><u>Politikat e reja të jenë në harmoni me kompetencat dhe strukturën komunale:</u> Në hartimin e politikave të reja, konsultimi paraprak dhe analizimi i kompetencave komunale, duhet të jetë pikënisje, në mënyrë që obligimet e reja të jenë brenda kapaciteteve, administrative dhe financiare.</p>	<p>Identifikimi i dykuptimësive dhe mbivendosjes së kompetencave në legjislacionin primar dhe sekondar;</p> <p>Krijimi i procedurave konsultuese dhe shpjeguese mbi zbatimin e saktë dhe efikas të politikave dhe legjislacionit;</p> <p>Nëpërmjet shkresave sqaruese, ministrinë dhe komunat t'i vendosin standardet e zbatimit të politikave/legjislacionit;</p> <p>Identifikimi i dykuptimësive ligjore dhe reduktimi/harmonizimi në procesin e rishikimit, ndryshimeve ligjore;</p> <p>Konsultimi paraprak me ministrinë përgjegjëse dhe komunat në procesin e rishikimit, ndryshimeve ligjore;</p> <p>Analiza e legjislacionit bazik dhe konsultimi paraprak me ministrinë sektoriale dhe komunat;</p> <p>Definimi i kompetencave/obligimeve me kapacitetet e shtuara administrative dhe financiare;</p> <p>Obligimet e nxjerra për komunat të marrin miratimin paraprak dhe financimin e qëndrueshëm.</p>
---	---	--	---

<p>Financat lokale</p>	<p>Mungesa e financimit të qëndrueshëm për shërbimet sociale;</p> <p>Financimi joadekuat i kompetencave të decentralizuara/centralizuara;</p> <p>Mungesa e financimit të qëndrueshëm ; dhe</p> <p>Financimi pa kritere nga qendra.</p>	<p><u>Mungesa e financimit të qëndrueshëm</u> për shërbimet sociale - Krijimi i grantit të veçantë dhe kritereve për financimin e shërbimeve sociale;</p> <p><u>Financimi joadekuat i kompetencave të decentralizuara/centralizuara - Vlerësimi i kompetencave dhe financimit;</u></p> <p><u>Mungesa e financimit të qëndrueshëm</u> – Financimi i qëndrueshëm i shërbimeve dhe krijimi i kontigjentës korrektuese të formulës së financimit;</p> <p><u>Disbalancimi i financimeve nga qendra</u> – Krijimi i kritereve për financime nga qendra, apo krijimi i një granti apo fondi për komunat.</p>	<p>Krijimi i një granti specifik, i cili do të përcaktonte një minimum të financimit të shërbimeve sociale;</p> <p>Shfrytëzimi i buxhetit që është tashmë i alokuar; financimi përmes shfrytëzimit dhe rritjes së fondit ekzistues për shërbime sociale;</p> <p>Rikthimi i kompetencave nga niveli qendror në nivel lokal (aty ku është i planifikuar financimi, ndërsa AME-ja të mbetet rregullator në vendosjen e standardeve);</p> <p>Financim i veçantë nga niveli qendror për shërbimet e centralizuara;</p> <p>Suficiti buxhetor; një qasje e re për menaxhimin e fondeve apo rregullimi i afateve për mbledhjen e të hyrave vetanake (komunat e mëdha);</p> <p>Inkorporimi i kontigjentës korrektuese për financimin e komunave të (vogla);</p> <p>Duhet të ndërtohen parime, standarde dhe kritere të qarta të financimit të ministrive të linjës nëpër komuna;</p> <p>Përfaqësim më gjithëpërfshirës në Komisionin e Granteve, duke propozuar kritere për financimin nga Ministrinë e linjës;</p> <p>Ligji vjetor i Buxhetit të reflektojë në parime për financimin nga ministrinë e linjës.</p>
-------------------------------	--	---	---

Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Bashkëpunimi Ndër-Komunal

Përkrahja e Qendrës për Zhvillimet Komunale

Aktualisht një përkrahje më e fokusuar në këto aspekte, specifikisht vërehet tek dy ministri: Ministria përkatëse për Pushtet Lokal dhe ajo për Financa. Përkundër ndërveprimit në kompetenca dhe përgjegjësi, një përkrahje teknike, operacionale dhe profesionale shihet si mangësi për zhvillimin e komunave. Raporti i Progresit për Kosovën (2019), nxjerr në pah se *“megjithëse pushteteve lokale u janë dhënë më shumë kompetenca, burimet e tyre njerëzore dhe financiare shpesh janë të pamjaftueshme”*¹⁹. Ndërkaq, në analizën e GAP-it ‘Sfidat e Komunave në Zbatimin e Ligjeve’ theksohet se *“ministritë si propozuese të ligjeve, nuk koordinohen me nivelin lokal në zbatimin e atyre ligjeve”*²⁰. Për më tepër, në mungesë të mekanizmave të veçantë që koordinojnë punën me komunat, në shumë raste krijohet fragmentim dhe mbivendosje në politika, legjislacion dhe financim. Madje, Raporti i Progresit për Kosovën (2020) thekson se *“pabarazitë e konsiderueshme midis komunave vazhdojnë dhe kufizimet e burimeve njerëzore dhe financiare vazhdojnë të ndikojnë negativisht në aftësinë e komunave për të realizuar mandatet e tyre”*²¹. Madje, këto obligime ligjore në shumë raste kërkojnë ndërtimin, vendosjen e pozitave të caktuara në komuna. Ky proces e vështirëson edhe më tutje funksionimin e strukturuar brenda komunal.

Qëndrueshmëria

Sipas analizës së Ministrisë Pushtetit Lokal, ‘Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale në Kosovës’, tek baza ligjore, përkatësisht rregullimi i bartjes së pushtetit thekson se *“korniza në njërin kahe ka krijuar mundësinë e decentralizimit të sistemit, ndërsa në kahen tjetër, ministritë e linjës dhe qeveria e kanë zhvilluar legjislacionin e tyre për disa segmente të qeverisjes, në mospërputhje me parimet dhe standardet e LVL-së. Zhvillimi dy-kahor i legjislacionit ka ndikuar që në njërin anë të decentralizohen të drejtat dhe përgjegjësitë e pushtetit lokal, dhe në anën tjetër, është bërë centralizimi i tyre nëpërmjet mekanizmave ligjorë dhe strukturave organizative ndër-sektoriale”*²². Ky proces ishte sfidues, sikur për komunat e themeluara dhe ato amë, duke shtruar nevojën për ristrukturim dhe ndërtim të mekanizmave komunalë. Në hulumtimin e Institutit KLGJ ‘Decentralizimi dhe Reforma e Qeverisjes Lokale’ theksohet se *“bartja efektive dhe efikase e kompetencave nga komunat amë dhe qeveria qendrore, do të jenë thelbësore për funksionim të suksesshëm të komunave të reja, sikurse do të jenë edhe kapacitetet njerëzore dhe financiare që do të kenë në dispozicion”*²³.

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, disa kompetenca kanë qenë të bartura nga procesi i decentralizimit në nivel lokal. Mirëpo, për shkak të ndryshimeve në ligjet sektoriale (Ligji për Zjarrfikje dhe Shpëtim dhe Ligji për Mbikëqyrjen e Tregut), disa prej tyre janë centralizuar, edhe pse buxheti ka mbetur në nivel lokal. Rast konkret, për këtë, është çështja e zjarrfikësve dhe Inspektorati për mbikëqyrjen e tregut. Kriteri i financimit për komuna për kokë banori është i definuar, megjithatë formula aktuale nuk i përgjigjet financimit adekuat të komunave të vogla. Për këtë, Ministria e Financave ka plotësuar dhe ndryshuar Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal²⁴, për një periudhë

¹⁹ Raporti i Progresit për Kosovën (2019)

²⁰ 94817_Gap Analizë 5 kompetencat.pdf (institutigap.org)

²¹ Raporti i Progresit për Kosovën (2020)

²² <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/03/ORGANIZIMI-DHE-FUNKSIONIMI-I-VETEQEVERISJES-LOKALE-NE-KOSOVE.pdf>

²³ https://www.klgi-ks.com/repository/docs/Decentralizimi_dhe_Reforma_e_Qeverisjes_Lokale_I_garte_ne_leter_i_turbullt_ne_Praktike_.pdf

²⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2525>

kalimtare deri në vitin 2019, ka ndarë 2.7% të grantit të përgjithshëm për komunat që kanë popullsi më pak se njëzetedymijë (22,000) banorë. Kjo me qëllim të sigurimit të nivelit minimal të shërbimeve komunale në komunat e caktuara. Andaj, në LPFL, duhet t'i jepet zgjidhje e qëndrueshme kësaj problematike. Për më tepër, Raporti për Kosovën thekson se është duke u hartuar një ligj i ri për financat lokale që adreson çështjet që ndërlidhen, ndër të tjera, me alokimet buxhetore, marrëveshjet për investime kapitale në nivel lokal, qëndrueshmërinë financiare të komunave të vogla dhe grantin specifik që përcakton mjetet për shërbimet sociale²⁵.

Pavarësisht progresit për një kohë të shkurtë që nga themelimi i Departamentit për Zhvillim Ekonomik Lokal në MAPL, ende shumë prej politikave sektoriale vazhdojnë të zbatohen pa koordinim ndërqeveritar dhe me komunat. Edhe Strategjia për VQL thekson se *“në mënyrë që zhvillimi ekonomik lokal të ketë një qasje sistemore, do të hartohen politikat nacionale zhvillimore për zhvillimin ekonomik lokal”*²⁶. Për këtë, në shumë raste, kemi dublikim dhe copëzim politikash dhe financimesh. Andaj, në Strategjinë për VQL, kërkohet *“të zhvillohen strategjitë zhvillimore të komunave dhe strategjitë për zhvillimin ekonomik të secilës komunë, duke konsoliduar kështu qasjen e integruar dhe sistemore të planifikimit strategjik zhvillimor lokal”*²⁷. Ndërkaq, Raporti i Progresit për Kosovën (2020), thekson se *“përveç transfereve të rregullta në formën e një granti të përgjithshëm, komunat marrin fonde të konsiderueshme për investime kapitale sipas gjykimit të ministrive të linjës”*²⁸.

Bashkëpunimi Ndër-Komunal

Vetëqeverisja Lokale në Kosovë, afirmon bashkëpunimin mes komunave si nevojë e rritjes së potencialit për avancim dhe zhvillim të segmenteve të caktuara të shërbimeve komunale. Ligji për Bashkëpunim Ndër-komunal²⁹, qartëson fushat dhe procedurat për bashkëpunim dhe ofrim të shërbimeve të përbashkëta. Megjithatë, ekzistojnë numër i vogël i praktikave që komunat kanë sprovuar procese të tilla.

Në fazën e parë, bashkëpunimi ndër-komunal (BNK) si proces është promovuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Programi i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm (UNPD)³⁰, që kanë nxjerrë një udhëzues për pjesëmarrje dhe zhvillim të iniciativave për BNK, duke nxitur dhe një skemë të donatorëve përmes fondeve stimuluese. Një proces të tillë, e ka rikthyer Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, përmes thirrjes për financim të projekteve për bashkëpunim ndër-komunal në vitin 2019³¹. Ngjashëm edhe në vitin 2021, MAPL-ja dhe partnerët kanë ofruar një seri, diskutimesh, punëtori dhe trajnime në këtë fushë. Po ashtu, nëpërmjet thirrjes së përbashkët MAPL - UN-HABITAT, ka nxitur dhe promovuar projektet e përbashkëta ndër-komunale. Mund të konstatojmë se kjo nismë pati dhënë rezultate, pastaj ky proces është ngadalësuar, duke u përdorur nga komunat vetëm si instrument në disa fusha teknike, që kryesisht lidhen me infrastrukturë rrugore. Janë një mori çështjesh që bashkëpunimi ndër-komunal do të arrinte të jepte rezultate pozitive, dhe për këtë, KLGJ ka adresuar vazhdueshëm nevojën për një fond stimulues, duke përfshirë edhe fondet e ministrive të linjës që janë investuar në komuna. Ndërkaq, nga analiza e shembujve të bashkëpunimit ndër-komunal nga Maqedonia mund të mësohet për (administrimin e përbashkët), Hungaria (pozitat e financuara bashkërisht) dhe Franca për (menaxhimin e përbashkët të shërbimeve publike).

²⁵ Raporti i Progresit për Kosovën (2019)

²⁶ Strategjia për Vetëqeverisje Lokale (2016-2016)

²⁷ Po aty

²⁸ Raporti i Progresit për Kosovën (2020)

²⁹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2749>

³⁰ Inter-municipal Cooperation for Development, Guidelines for Participating in the Inter-municipal Cooperation for Development Initiative, 2007

³¹ <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2017/03/1.pdf>

	Segmenti	Fushat për intervenim	Çështjet kyçe për adresim
	<p>Përkrahja e qendrës për zhvillime komunale</p> <p>Përkrahja teknike, operacionale dhe profesionale;</p> <p>Koordinimi dhe konsultimi mes qendrës në zbatimin e ligjeve;</p>	<p><u>Përkrahja teknike, operacionale profesionale</u> – Avancimi i mekanizmave të përkrahjes për komunat dhe hartimi i planit për mbështetje teknike, operacionale dhe profesionale. Njëkohësisht, në procesin e hartimit të politikave të reja, apo reformave të parashihet një plan veprimi edhe mbështetje për komunat;</p> <p><u>Koordinimi dhe konsultimi mes qendrës dhe komunave në zbatimin e ligjeve</u> – Forcimi i mekanizmit të konsultimit dhe vendosja e standardeve dhe monitorimit, ku njëkohësisht të eliminohet dublikimi dhe fragmentimi i politikave dhe buxheteve;</p>	<p>Përfshirja e planeve të veprimit dhe mbështetjes për komunat në procesin e hartimit të politikave të reja apo reformave;</p> <p>Ndërtimi i mekanizmave adekuat për koordinim me komunat dhe vendosja e një kalendari të përbashkët të politik-bërjes dhe vendimmarrjes;</p> <p>Në harmonizimin e strategjive/planeve nacionale dhe lokale, të behet analiza e hendeqeve mes strategjive nacionale dhe lokale, si dhe analiza e hendeqeve mes strategjive nacionale dhe lokale;</p>

<p>Qëndrueshmëria</p>	<p>Ndërtimi dhe ri-strukturimi i mekanizmave komunal për qartësimin e legjislacionit;</p> <p>Qëndrueshmëria financiare e komunave;</p>	<p><u>Ndërtimi dhe ri-strukturimi i mekanizmave komunalë për qartësimin e legjislacionit</u> – Ulja e ambiguitetit dhe harmonizimi i legjislacionit në funksion të zbatimit efikas dhe efektiv të kompetencave;</p> <p><u>Qëndrueshmëria financiare e komunave</u> – Ndërmarrja e veprimeve nga Institucionet e Kosovës që të sigurojnë qëndrueshmëri financiare, teknike dhe operacionale dhe krijimi i një mekanizmi të komunikimit dhe bashkëpunimit ndër-institucional në konsolidimin e komunave të decentralizuara.</p>	<p>Bartja efektive dhe efikase e kompetencave nga komunat amë dhe qeveria qendrore do të jenë thelbësore për funksionim të suksesshëm të komunave të reja, sikurse do të jenë edhe kapacitetet njerëzore dhe financiare që do të kenë në dispozicion;</p> <p>Institucionet e Kosovës duhet të ndërmarrin veprime që të sigurojnë qëndrueshmëri financiare, teknike dhe operacionale;</p> <p>Krijimi i një mekanizmi të komunikimit dhe bashkëpunimit ndër-institucional në konsolidimin e komunave të decentralizuara.</p>
------------------------------	--	---	--

<p>Bashkëpunimi Ndër-Komunal</p>	<p>Fushat dhe segmentet në ofrimin e përbashkët të shërbimeve publike;</p> <p>Krijimi i fondit stimulues për bashkëpunimin ndër-komunal ;</p> <p>Zhvillimi i BNK-së si proces i paraprin edhe zhvillimit rajonal duke vendosur balancë zhvillimore.</p>	<p><u>Fushat dhe segmentet në ofrimin e përbashkët të shërbimeve publike</u> – Përmes administrimit të përbashkët mund të vendoset objektiv në përmirësimin dhe menaxhimin e çështjeve lokale. Po ashtu, në rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve komunale me çmime të pranueshme, duke analizuar avantazhet, me fokus në ngritjen e efikasitetit ekonomik;</p> <p><u>Krijimi i fondit stimulues për bashkëpunimin ndër-komunal</u> – Fondi stimulues, bazuar në praktikat paraprake dhe modelet e avancuara;</p> <p><u>Zhvillimi i BNK-së si proces i paraprin edhe zhvillimit rajonal, duke vendosur balancë zhvillimore</u> – Fuqizimi i kërkesave të përbashkëta të komunave karshi institucioneve qendrore, investitorëve dhe donatorëve.</p>	<p>Ofrimi i asistencës teknike për identifikim të fushave të përbashkëta të ofrimit të shërbimeve dhe menaxhimi i përbashkët i shërbimeve publike, duke përfshirë edhe iniciativat për projektet e përbashkëta;</p> <p>Financimi i projekteve të mëdha nga ministritë e linjës dhe stimulimi i iniciativave ndër-komunale, në veçanti (impiantet, deponitë, ujësjellësi, riciklimi, ngrohja);</p> <p>Të bëhet harmonizimi i strategjive komunale me strategjitë nacionale dhe të identifikohen fushat e përbashkëta me potencial zhvillimor rajonal.</p>
---	---	--	--

Rrafshi Komunal

Qeverisja Brenda-Komunale

Në procesin e decentralizimit, Pushteti Lokal në Kosovë ka pësuar një transformim të thellë, jo vetëm në numrin e komunave, por edhe strukturën e funksionimit. Këtij ndryshimi i ka paraprirë rregullorja për Vetëqeverisjen Lokale UNMIK, 2007/30³², e cila ka themeluar degën ekzekutive në komuna. Kësisoj, kryetari i komunës është zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët, që njëkohësisht përfaqëson ekzekutivin komunal. Në analizën mbi organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale, tek rregullimi i sistemit të vetëqeverisjes lokale në Kosovës trajtohet tranzicioni, ku theksohet se *“fillimisht të drejtat dhe përgjegjësitë e autoriteteve lokale, të përcaktuara me rregulloret e UNMIK-ut, kanë qenë më pak autonome se sa kompetencat e përcaktuara më vonë me ligjet e miratuara nga autoritetet e Republikës së Kosovës (2008). Kjo do të thotë se me kalimin e kohës autoritetet lokale, me kornizën e re ligjore, fituan më shumë kompetenca dhe në të njëjtën kohë edhe më shumë autonomi të qeverisjes”*³³.

Me rregullore ishin përcaktuar qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e pjesës politike të sistemit (kuvendit dhe kryetarit të komunës) dhe pjesës ekzekutive, që ishin në përputhje edhe me rregulloret tjera organike për shërbimin civil në administratën publike³⁴. Edhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale³⁵, përveç kompetencave të shtuara për komunat, ka fuqizuar rolin e kryetarit të zgjedhur drejtpërdrejt. Njëkohësisht, qytetarët zgjedhin edhe përfaqësuesit në Kuvendin e Komunës. Përderisa, administrata komunale parashihet të funksionojë në bazë të Legjislacionit për Shërbyesit Civilë³⁶, përkatësisht Ligjit për Zyrtarët Publikë³⁷. Kjo formë ka rritur kredencialet demokratike, megjithatë sfidë ende mbetet komunikimi dhe bashkëpunimi brenda-komunal, në veçanti në tri (3) segmente (Kuvendi – Kryetari – Administrata Komunale).

Instituti KLGJ, në vitin 2012³⁸, ka kryer një analizë të funksionimit të komunave, në veçanti mbi kontrollin dhe balancën e pushteteve, ku konstatohet se sistemi aktual ka fuqizuar rolin e kryetarit, por ka zbehur atë të kuvendit dhe se nuk ekziston një vijë e qartë e udhëheqjes dhe kontrollit mbi administratën. Vendosja në krye të ekzekutivit të kryetarit të zgjedhur drejtpërdrejt nga partia politike dhe shuarja e pozitës së kryeshefit ekzekutiv, ka forcuar kontrollin politik mbi administratën dhe ka zbehur (vazhdimësinë) memorien institucionale. Raporti i Progresit për Kosovën (2020), nxjerr në pah mungesën e kontrollit dhe balanceve të pushteteve dhe ndikimin politik mbi administratën, duke nxjerrë në pah se *“Asambletë komunale kanë kompetenca të kufizuara efektive buxhetore dhe ushtrojnë mbikëqyrje të pamjaftueshme mbi administratat komunale, ndërsa ndikimi i tepruar politik mbi administratat lokale dobëson qeverisjen lokale”*³⁹.

³² https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/02english/E2007regs/RE2007_30.pdf

³³ <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/03/ORGANIZIMI-DHE-FUNKSIONIMI-I-VETEQEVERISJES-LOKALE-NE-KOSOVE.pdf>

³⁴ Po aty

³⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

³⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2679>

³⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2679>

³⁸ https://klgi-ks.com/repository/docs/KRYETARI_KOMUNAL_PERFAQESUES_APO_DOMINUES.pdf

³⁹ Raporti i Progresit për Kosovën (2020)

Shërbimet Administrative dhe Publike

Konsolidimi i administratës komunale ka kaluar në sfida zinxhirore, duke akomoduar kontingjentin e punonjësve të larguar në vitet e 90-a. Përderisa, parimet e qeverisjes së mirë dhe zhvillimit të qëndrueshëm janë promovuar në këto vite, punonjësit kanë qenë të përjashtuar⁴⁰. Po ashtu, edhe punësimet në fazën e rindërtimit, janë ndjekur nga mungesa e kriterëve dhe procedurave të qarta, pa përjashtuar edhe ndikimet partiake. Nuk mund të përjashtohet edhe fakti se administrata publike komunale, ka qenë e demotivuar në pagesë, me pamundësi teknike e paqartësi ligjore e procedurale. Me gjithë këto kufizime, administrata publike ka arritur të mbajë “vitale” shërbimet administrative. Në 2008-ën, e gjithë rregullativa ligjore u adaptua nga ajo e UNMIK-ut në Legjislacionin vendor, megjithatë nevoja për konsolidim të plotë të institucioneve, ishte sfida që doli përpara. Në pamundësi, për vlerësim e reformë, e me shumë ndryshime strukturore e ligjore, administrata komunale u gjet përballë, kompetencave të shtuara e kapaciteteve të limituara për zbatim. Nga 2008 deri në 2010, nuk vërehen ndryshime apo reforma në këtë sektor.

Në 2010, u hartua strategjia për reformën e administratës publike (2010-2013)⁴¹, e pasuar nga strategjia për modernizim të administratës publike (2015-2020)⁴². Në 2019-ën, Kuvendi i Kosovës miratoi tri ligjet e pakos së reformës (Ligjin për Zyrtarët Publikë⁴³; Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura⁴⁴ dhe Ligjin për Pagat⁴⁵). Dy ligjet e para, janë tashmë në fuqi, ndërkaq ai për pagat u shpall i pavlefshëm nga Gjykata Kushtetuese⁴⁶. Në Raportin e Progresit për Kosovën (2020), theksohet se *“Kordinimi i dobët qendror dhe ndërministror mbetet një sfidë për zbatimin e përgjithshëm të reformës. Gjatë periudhës së raportimit, rekrutimet jo të bazuara në meritë mbeten një shqetësim, ndërsa politik-bërja gjithëpërfshirëse dhe e bazuar në prova u pengua nga vendimet ad hoc, shpesh të ndikuara nga interesa të veçanta”*⁴⁷.

Pavarësisht procesit të reformës, mbetet ende shumë punë në zbatim të legjislacionit dhe modernizim të administratës publike. Raporti i Progresit për Kosovën (2020), thekson se *“Zbatimi i Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Publike dhe të Agjencive të Pavarura i cili hap rrugën për një administratë më efikase duke respektuar parimet e meritës dhe transparencës, aktualisht pengohet nga mungesa e legjislacionit të miratuar zbatues”*⁴⁸. Po ky raport, thekson se *“Kapaciteti i Institutit të Kosovës për Administratë Publike me një buxhet të kufizuar dhe aftësi të limituar për të ofruar trajnimet e nevojshme mbetet i dobët, gjë që vazhdon të pengojë procesin e rekrutimit dhe zhvillimit profesional të nëpunësve civilë. Vlerësimet e performancës vazhdojnë të kenë pak ndikim në zhvillimin e karrierës. Kjo minon zbatimin e Ligjit për Zyrtarët Publikë, në veçanti për rekrutimin, trajnimin fillestar dhe zhvillimin profesional të nëpunësve civilë”*⁴⁹.

⁴⁰ <https://www.econstor.eu/bitstream/10419/50227/1/390769290.pdf>

⁴¹ <https://mpb.rks-gov.net/ap/desk/inc/media/63CA2FB1-FCB8-4E28-92FF-CEE1B589EDDC.pdf>

⁴² <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia-per-Modernizimin-e-Administrates-Publike-Shtator-2015-2020.pdf>

⁴³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=25839>

⁴⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18684>

⁴⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18683>

⁴⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=29924>

⁴⁷ Raporti i Progresit për Kosovën (2020)

⁴⁸ Ibidem

⁴⁹ Ibidem

Demokracia e drejtpërdrejtë – qeverisja e mirë

Që nga viti 2008, Kosova ka miratuar legjislacionin për vetëqeverisjen lokale, legjislacion ky që afirmon demokracinë e drejtpërdrejtë dhe mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve. Sidoqoftë, përkundër përpjekjeve, niveli i pjesëmarrjes dhe konsultimit mbetet sfidues, me theks të veçantë, në konsultimin e akteve komunale dhe përfshirjes në procesin e konsultimit. Në njërin anë, kjo është rezultat i mungesës së kapaciteteve, paqartësive në zbatimin e rregullativës, mungesës së praktikave të konsoliduara, modeleve dhe në anën tjetër, mungesës së vullnetit politik dhe kulturës jo mjaftueshëm të konsoliduar.

Për më tepër, kërkesa për përgjegjësi efektive dhe monitorim të vazhdueshëm sfidohet edhe nga kapacitetet e kufizuara të shoqërisë civile; mungesës së metodologjive dhe formave standarde të monitorimit. Sistemi i vetëqeverisjes lokale, ka afirmuar parimet e qeverisjes së mirë të normuara nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, posaçërisht Kapitulli 9, “Demokracia Direkte dhe Pjesëmarrja Qytetare”. Po ashtu, edhe rregullativa përcjellëse, ka avancuar procesin e përfshirjes, konsultimit, me qëllim rritjen e pronësisë së publikut në politik-bërje dhe vendimmarrje. Udhëzimi Administrativ 04/2018 mbi Standardet Minimale për Konsultimin Publik në Komunat, përcakton detyrat dhe detyrimet në fushën e konsultimit publik të akteve ligjore komunale, gjithashtu ndihmon në zbatimin e Udhëzimit Administrativ 01/2015 për Transparencën në Komuna.

Komunat si njësi vetëqeverisëse lokale duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale neni 68.1, janë të obliguara të vënë në funksion takimet publike, si parime bazë të komunikimit drejtpërdrejt me qytetarë, ku secili person apo organizatë me interes ka të drejtë të marrë pjesë. Kuvendi i Komunës, bazuar në nenin 73, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe UA (MAPL) Nr.01/2016, është i obliguar të themelojë edhe komitetet konsultative, me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Megjithatë, duke iu referuar "Raportit për Vendin" nga Komisioni Evropian, vihet re se bashkëpunimi midis shoqërisë civile dhe qeverisë në nivelin qendror po përmirësohet, ndërsa në nivelin lokal thekson se nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar angazhim dhe bashkëpunim të plotë. Për më tepër, për të siguruar qasje efektive, rregullativa parasheh edhe procese të veçanta afirmative të hartimit të buxheteve, nëpërmjet buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (BPGj), ku synohet përmirësimi i barazisë së grave dhe burrave në bazë të një analize gjinore në secilën fazë të planifikimit, programimit, dhe realizimit të buxheteve komunale.

	Segmenti	Fushat për intervenim	Çështjet kyçe për adresim
Qeverisja Brenda-Komunale	<p>Mekanizma të dobët të kontrollit dhe balancit;</p> <p>Rritja e rolit partiak në administrimin e administratës;</p> <p>Ndërveprim të ulët mes akterëve komunalë.</p>	<p><u>Mekanizma të dobët të kontrollit dhe balancit</u> - Në procesin e vlerësimit të qeverisjes lokale, të parashihen mekanizma të mbikëqyrjes dhe balancit të pushteteve, duke siguruar funksionim efikas dhe llogaridhënie;</p> <p><u>Rritja e rolit partiak në administrimin e administratës</u> - Në procesin e vlerësimit, duhet të parashihet ndarja e qartë në mes vizionit politik dhe administratës, duke rishikuar edhe nevojën për vendosjen e një mekanizmi udhëheqës për stafin civil, që do të forconte vazhdimësinë dhe memorien institucionale;</p> <p><u>Ndërveprim të ulët mes akterëve komunalë</u> – Komunitat të fuqizojnë mekanizmin e konsultimit, përfshirjes dhe bashkë-krijimit të politikave me akterët lokalë. Në veçanti, duke fuqizuar mekanizmat aktual si: Këshillat e Fshatrave dhe Lagjeve; Komitetet Konsultative Profesionale dhe Komitetet Sektoriale në Kuvend.</p>	<p>Të zhvillohen analiza të opsioneve për forcimin e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe balancit të pushteteve dhe fuqizimi i trupave aktualë komunalë për mbikëqyrje dhe përfshirje në politik-bërje;</p> <p>Të zhvillohen analiza të opsioneve të vlerësimit për mekanizmat e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies së administratës dhe të forcohen mekanizmat që sigurojnë (vazhdimësi) memorie institucionale;</p> <p>Forcimi i mekanizmave (trupave) komunalë për konsultim, përfshirje, mbikëqyrje dhe bashkë-krijim të politikave lokale;</p> <p>Ndërtimi i mekanizmave dhe agjendave për bashkëpunim dhe koordinim mes akterëve lokalë.</p>

<p>Shërbimet Administrative dhe Publike</p>	<p>Ndikimi i lartë politik në administratën lokale;</p> <p>Mungesa e vlerësimit dhe planeve për organizim/sistema tizim dhe reforma;</p> <p>Problemet në funksionimin e ndërmarrjeve publike lokale;</p> <p>Ndërlidhja e dobët e sistemeve dhe vargu i gjatë i proceseve dhe procedurave.</p>	<p><u>Ndikimi i lartë politik në administratën lokale</u> – Qartësimi i përgjegjësive në operacionalizimin e veprimeve komunale, por edhe të llogaridhënies efektive;</p> <p><u>Mungesa e vlerësimit dhe planeve për organizim/sistematizim dhe reforma</u> – Kërkohet avancim i proceseve, si dhe strategji dhe plane të veprimit për administratën komunale, në mënyrë që të përmirësohet qasja ad-hoc për ri-sistemim, limitet në rekrutim dhe shumë sfida tjera të administratës;</p> <p><u>Problemet në funksionimin e ndërmarrjeve publike lokale</u> – Të bëhet përmirësimi i procedurave dhe forcimi i qëndrueshmërisë së ndërmarrjeve publike lokale;</p> <p><u>Ndërlidhja e dobët e sistemeve dhe vargu i gjatë i proceseve dhe procedurave</u> – Të bëhet unifikimi dhe standardizimi i shërbimeve, si dhe duhet të zhvillohen procese të konsultimit të hollësishëm me komunitetet lokale (udhëheqësit e fshatrave, bizneset, shoqëria civile) për përcaktimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve.</p>	<p>Të bëhet ndarja e qartë mes nivelit politik dhe atij të administratës, të bëhet avancimi i planeve, procedurave të qarta për administratën, si dhe forcimi i rolit dhe llogaridhënies së drejtorëve, karshi Kuvendit Komunal;</p> <p>Të Identifikohen sfidat (horizontale – vertikale) dhe të krijohen modele për procesin e ri-sistemimit;</p> <p>Të bëhet eliminimi i krijimit/mbivendosjes së strukturave nga ministritë/legjislacioni sektorial, si dhe avancimi i metodologjive dhe formave për vlerësim dhe avancim;</p> <p>Identifikimi i sfidave, analiza e opsioneve dhe rekomandimeve për rritjen e cilësisë së shërbimeve publike, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit;</p> <p>Identifikimi/analiza e proceseve dhe procedurave komunale, qartësimi/thjeshtëzimi i procedurave dhe lidhja e sistemeve, si dhe ndërtimi i sistemit të integruar dhe e-portalit për shërbime.</p>
--	---	--	--

<p>Demokracia e drejtpërdrejtë – qeverisja e mirë</p>	<p>Pjesëmarrja dhe debatet në takimet publike mes komunave dhe qytetarëve;</p> <p>Konsultimi i akteve komunale me publikun;</p> <p>Zhvillimi i mekanizmave të nivelit nën-komunal dhe trupat e kuvendit;</p> <p>Angazhimi dhe përfshirja e shoqërisë civile në hartimin e politikave publike.</p>	<p><u>Pjesëmarrja dhe debatet në takimet publike mes komunave dhe qytetarëve</u> – Të bëhet forcimi i komunikimit dhe konsultimit mes akterëve;</p> <p><u>Konsultimi i akteve komunale me publikun</u> – Rritja e transparencës komunale në konsultimi e akteve komunale me publikun;</p> <p><u>Zhvillimi i mekanizmave të nivelit nën-komunal dhe trupat e kuvendit</u> – Themelimi i Këshillave të Fshatrave dhe mbajtja e takimeve, si dhe sigurimi i barazisë gjinore në takime;</p> <p><u>Angazhimi dhe përfshirja e shoqërisë civile në hartimin e politikave publike</u> – Rritja e nivelit të financimit publik të organizatave të shoqërisë civile nga niveli lokal, si dhe përfshirja e tyre në hartimin e politikave publike, ligjeve dhe rregulloreve komunale.</p>	<p>Ofrimi i ndihmës teknike dhe profesionale për komunat në komunikim efektiv mes akterëve;</p> <p>Ofrimi i ndihmës teknike dhe profesionale për të përmirësuar zgjerimin e organizimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në takimet e komunës;</p> <p>Ndihma teknike dhe profesionale për komunat dhe organizatat e shoqërisë civile, për inkurajimin e një pjesëmarrjeje më të madhe në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve lokale;</p> <p>Hartëzimi i procesit dhe rolit të mekanizmave komunalë, për pjesëmarrje dhe konsultim;</p> <p>Mbështetja e Zyrave për Barazi Gjinore në organizimin e seminareve të aftësisë dhe/ ose asistencës teknike në punë për zyrtarët komunalë për çështje gjinore;</p> <p>Asistencë teknike dhe profesionale për të mbështetur bashkëpunimin ndërmjet zyrtarëve gjinorë komunalë, përfaqësuesve politikë komunalë dhe organizatave të shoqërisë civile.</p>
--	---	---	--

Perspektiva e KLGJ-së mbi prioritetet e qeverisjes lokale

Koordinimi dhe dialogu i përhershëm me komunat

Konsolidimi i mekanizmave të koordinimit, dialogut dhe komunikimit të strukturuar me komunat, duke bërë bashkë të gjithë akterët në funksion të zhvillimit. Ky mekanizëm i vendimmarrjes të fuqizohet edhe në konsultimin efektiv për hartimin e politikave/legjislacionit. Rritja e pronësisë së komunave në hartimin e legjislacionit/politikave dhe identifikimi dhe adresimi i provizioneve që pengojnë zhvillimin e komunave. Qasje pro-aktive, në adresimin e pengesave ligjore që dalin pengesë për zhvillimet komunale.

Politika dhe buxhete të integruara në funksion të zhvillimit

Në procesin e reformës për efikasitetin e ekzekutivit (Qeverisë) duhet të sigurohet mbështetje e integruar e nivelit qeveritar për komunat. Përcaktimi i qartë i fushëveprimit të dikastereve qeveritare dhe koordinimi i plotë me komunat do të shmangë fragmentimin e politikave dhe buxheteve, për të ndërtuar një sistem të integruar të politikave dhe investimeve në funksion të zhvillimit.

Zhvillimi Policentrik

Ekziston nevoja për një program të veçantë ndërqeveritar, për të ulur disharmoninë dhe disbalancin zhvillimor. Hartimi i një programi të veçantë nacional për dekoncentrim dhe shtrirje të shërbimeve, projekteve kapitale dhe aspekteve socio-kulturore. Program ky, që në varësi prej specifikave të lokaliteteve, do të propozonte/implementonte plane të veçanta të investimeve, duke përfshirë sheshe, parqe, qendra rekreative sportive dhe qendra administrative të shërbimeve. Mes tjerash, ky program i veçantë mund të vendos në fokus sanimin e degradimit urban, rritjen e funksionalitetit dhe mobilitetit të qyteteve dhe estetikën urbane.

Zonat e Veçanta Zhvillimore

Në kuadër të një plani nacional dhe fokusi sektorial për zhvillim të komunave, duhet të identifikohen dhe hartohen plane të veçanta të zonave zhvillimore në komunat e Kosovës, bazuar në potencialin dhe traditën për zhvillim. Kësisoj, komuna dhe qeveria do të mund të bashkërendojnë investimet dhe mbështetjet për fuqizimin e zhvillimit. Zonat e veçanta zhvillimore përfshijnë ato të: turizmit historik, kulturor, rural dhe ato me potencial të bujqësisë, agro-turizmit dhe prodhimit e përpunimit të produkteve vendore.

Shërbime të Integruara dhe digjitalizimi

Me përmbylljen e reformës së administratës publike, digjitalizimi i plotë na mundëson dekoncentrimin në qendra të ofrimit të shërbimeve të integruara, ku qytetarët dhe bizneset në vetëm një sportel arrijnë të marrin shërbimin e plotë për të gjitha kërkesat dhe procedurat administrative. Në të njëjtën kohë duhet të iniciohet/zhvillohet portali i E-qeverisjes për të gjitha nivelet. Duke i paraprirë integrimi i shërbimeve administrative i të gjitha niveleve në një mekanizëm. Duke ofruar module të veçanta në menaxhimin e sistemeve digjitale. Njëkohësisht, në përmirësimin e kapaciteteve për inovacion, të ofrohen udhëzues dhe praktika, duke harmonizuar me Strategjinë për Inovacion dhe Qeverisje të mirë në nivel lokal të Këshillit të Evropës, dhe veprimeve të qyteteve rajonale dhe evropiane.

Qendrat për Projekte Zhvillimore

Në kuadër të mbështetjes për komunat ekziston nevoja për themelimin e qendrave për projekte zhvillimore. Këto qendra që do të hartojnë politika dhe plane për zhvillim të qëndrueshëm komunal, projekte për komunat për qasje në fondet zhvillimore dhe projekte të përbashkëta me qytetarët, bizneset, mërgatën dhe investitorët në fusha me potencial zhvillimor, duke rritur edhe ndikimin e përkrahjes buxhetore të investimeve dhe subvencioneve.

Adresimi i sfidave kyçe (të përbashkëta) për Komunat e Kosovës

Nëpërmjet një analize të veçantë duhet identifikuar sfidat kyçe të komunave në fushat sektoriale dhe inkorporimin në planet nacionale. Ky plan nacional do të bëjë të plotë koordinimin për t'iu përgjigjur sfidave të komunave dhe investimet mbi këto nevoja. Projektet e mëdha kapitale, në të cilat, të vetme komunat nuk mund të arrijnë t'i zgjedhin, mund të gjejnë mbështetjen përmes këtij plani. Kjo, do të përfshijë: ndërtimin e kapaciteteve të reja të ujërave; impiantet e trajtimit të ujërave të zeza dhe mbetjeve; projektet kapitale për zgjerim të qyteteve; menaxhimin e rreziqeve dhe fatkeqësive; integrimin e grupeve të rrezikuara të shoqërisë dhe projektet investive në potencialin zhvillimor.

Qendra e Resurseve

Ekziston nevoja për themelimin e një qendre të veçantë të resurseve, e cila do të kthehej në një mekanizëm të mbështetjes në hartimin, avancimin e politikave publike në nivel lokal. Ky mekanizëm, në të njëjtën kohë do të ofrojë trajnime të avancuara për zbatimin e politikave, përditësimin e njohurive me proceset e reja, ndjekjen e modeleve dhe trendëve ndërkombëtare në fushën e qeverisjes lokale, asistencë teknike dhe profesionale nga ministritë e linjës.

Koordinimi i Fondeve Zhvillimore

Konsolidimi i mekanizmit për koordinim dhe konsultim me partnerët zhvillimorë në agjendën e përbashkët të zhvillimit të qëndrueshëm. Një kalendar i proceseve publike në të gjitha nivelet, ku do të përfshiheshin akterët kyç, do të rriste ndjeshëm potencialin e përbashkët në funksion të zhvillimit.

Forcimin e bashkëpunimit rajonal;

Ekziston nevoja të rrisin nivelin e bashkëpunimit dhe dialogut në mes autoriteteve lokale në rajon, duke ndërtuar një platformë të dialogut, komunikimit dhe bashkëpunimit rajonal, shkëmbimit të praktikave dhe nxitjes së nismave të përbashkëta, identifikimit dhe nxitjes së iniciativave për ndërtim të programeve dhe aplikimeve të përbashkëta në fondet zhvillimore (IPA, Fondet regjionale). Në të njëjtën kohë, nevojitet një mekanizëm lehtësues në adaptimin dhe bartjen e përvojave në proceset integruese të shteteve përkatëse.



**KOSOVO LOCAL
GOVERNMENT
INSTITUTE**

Kosovo Local Government Institute

Address: Str. Enver Gjerqeku no. 20, 10000

Prishtinë, Republic of Kosova

Tel: +383 (0) 38 522 000

Mobile: +383 (0) 44 253 835

E-mail: info@klgi-ks.com | Web: www.klgi-ks.com